



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°9/2021

Hagë, 11/11/2021

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Dëshmitari i katërt i thirrur nga Prokuroria në çështjen *Gucati dhe Haradinaj* përfundoi dëshminë e tij të premtën e shkuar, më 5 nëntor. Dëshmitari ishte punonjës i ZPS-së dhe dëshmoi pa masa mbrojtëse.

Ditën e hënë gjatë procedurave të gjyimit ZPS-ja kërkoi leje për apelimin e vendimit të Trupit Gjykses lidhur me nxjerrjen e materialeve. Kërkesa e ZPS-së u rrëzua nga Trupi Gjykses ditën e mërkurën dhe vendimi përkatës mund të gjendet në faqen tonë zyrtare.

Po ashtu ditën e hënë, Mbrojtja e z. Gucati dhe z. Haradinaj bënë me dije se synojnë të kërkojnë rrëzimin e të paktën pesë prej akuzave të ngritura në Aktakuzën kundër klientëve të tyre. Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen që të dorëzojë çdo mocion të tillë brenda datës 17 nëntor.

Më 10 nëntor, ZPS-ja në këtë çështje gjyqësore dorëzoi zyrtarisht njoftimin ku bënte me dije se kishte përfunduar me paraqitjen e provave të veta. Trupi Gjykses caktoi 6 dhjetorin si datë provizore për nisjen e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.

Ditën e mërkurë filloi dëshmia e dëshmitarit të gjashtë në gjykimin e Salih Mustafës. Dëshmitari është duke dëshmuar lidhur me mbajtjen e tij si i ndaluar në kompleksin

1





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°9/2021

Hagë, 11/11/2021

e ndalimit në Zllash. Dëshmitari është duke dëshmuar me masa mbrojtëse, ku përfshihet përdorimi i një pseudonimi si dhe ndryshimi i zërit dhe i fytyrës.

Më 10 nëntor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Pjetër Shalës. Vendimi mund të gjendet në faqen tonë zyrtare. Seanca e procedurës paraprake e ardhshme për këtë çështje është planifikuar për të hënë, më 15 nëntor.

**Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

